



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:124771

Datë: 12.06.2024

Numri i dokumentit: 05813875

KA.nr.574/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “BENI COM” SH.P.K., me numër të biznesit 80303122, me seli në Obiliq adresa fshati Shkabaj lider i grupit të operatorëve ekonomik në konzorcium “LINDA” SH.P.K dhe “EURO Infrastruktura”, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), me seli në Prishtinë, adresa rruga “Migjeni”, ish ndërtesa e Bankës Lubjanës, Kati i V-të, për shkak të anulimit të Vendimit PSH.nr. nr.594/20 të datës 30.09.2020, i të paditurës OSHP, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik më datë 14.05.2024 në mungesë të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit dhe përfaqësuesit të palës së paditur, ndërsa më datë 21.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit “BENI COM” SH.P.K., me numër të biznesit 80303122, me seli në Obiliq, fshati Shkabaj lider i grupit të operatorëve ekonomik në konzorcium “LINDA” SH.P.K dhe “EURO Infrastruktura”, si e bazuar.
- II. **ANULOHET** pjesërisht vendimi PSH.nr. nr.594/20 të datës 30.09.2020, si në pikën II të dispozitivit, si i kundërligjshëm i nxjerrë nga e paditura Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), me të cilin ka vërtetimin për dhënjen e kontratës.
- III. **KONSTATOHET** i kundërligjshëm vendimi për dhënien e Kontratës “Ndërtimi i parkut rekreativo-sportiv në Dardani dhe renovimi i hapësirës”, nr. i prokurimit 616-19-7632-5-1-1, nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës.
- IV. Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Më datë 01.10.2020, në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative paditësi “BENI COM” SH.P.K., me seli në Obiliq ka parashtruar padi e evidentuar me nr. A.1612/2020, kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit (tutje referuar OSHP), me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit PSH.nr. 594/20 të datës 30.09.2020 i të paditurës OSHP, i të paditurës OSHP me propozim që të aprovet në tërësi si e bazuar kërkesëpapia e paditësit, të detyrohet e paditura OSHP që ta ndryshoj vendimin e kundërshtuar të datës PSH.nr. 594/20 të datës 30.09.2020, duke aprovuar në tërësi pretendimet në ankesë të paditësit OE “Beni Com” SH.P.K.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr. 574/22.
3. Gjykata mbajti seancë të shqyrtimit kryesor më datë 14.05.2024 konform nenit 41 të LPK-së, në mungesë të përfaqësuesit të paditësit të ftuar në mënyrë të rregullt ftesën për në seancë e ka pranuar më datë 17.04.2024 dhe në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur të ftuar në mënyrë të rregullt, ftesën për në seancë e ka pranuar më datë 18.04.2024.

Pretendimet e paditësit

4. Përfaqësuesi i paditësit në pretendimet e dhëna në padi ka deklaruar se Autoriteti Kontraktues (tutje referuar si AK) Komuna e Prishtinës më datë 25.11.2019, ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit nr. 616-19-7632-5-1-1 me titull “Ndërtimi i parkut rekreativo-sportiv në Dardani dhe Renovimi i Hapësirës, ndërsa më datë 09.12.2019 është bërë hapja publike e ofertave dhe përfundimisht më datë 31.01.2020 grupi i OE “BENI COM”, në konsorrcium me OE “LINDA”, “EURO

INFRASTRUKTURA” shpërblehet me kontratë. Më datë 17.04.2020 është ndryshuar vendimi i parë dhe në rivlerësim është shpërblyer me kontratë grupi i OE “REXHA” SH.P.K., tani i rekomanduar, ndërsa më datë 21.04.2020 grupi i OE-ve “BENI COM”, “LINDA”, “EURO INFRASTRUKTURA”, AK parashtruar kërkesë për rivlerësim pranë AK-së.

5. Ka shtuar se të pakënaqur me vendimin e AK-së i cili ka anuluar vendimin e parë të datës 31.01.2020 dhe me vendimin e dytë më datë 24.04.2020 ka shpërblyer me kontratë operatorin e rekomanduar, ka parashtruar ankesë më datë 01.05.2020 pranë OSHP-së, ndërsa OSHP-ja nxjerr vendimin me nr. PSH.nr. 274/20 të datës 15.06.2020 duke aprovuar pretendimet e parashtruara nga OE “BENI COM” SH.P.K., gjykon çështjen e konfliktit të interesit shkak i eliminimit të paditësit dhe e kthen lëndën në rivlerësim të AK. Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës, përkundër vërejtjeve dhe obligimeve nga vendimi paraprak i OSHP-së ka shkelur dispozitat e Ligjit për Procedurën e Prokurimit (tutje LPP) në veçanti nenet 59.2 65 dhe 72 dhe ka qenë e obliguar që gjatë rivlerësimit të ofertave të kërkoj sqarime nga OE për ti sqaruar projektet e prezantuara në ofertë. Kundër vendimit të AK-së paditësi ka parashtruar ankesë, ndërsa OSHP-ja me vendimin PSH.nr. 594/20 të datës 30.09.2020 gjykon përsëri për të njëjtën çështje të cilën e ka gjykuar me vendimin e parë PSH.nr. 274/20 të datës 15.06.2020 duke u thirrur në një opinion juridik të lëshuar nga Agjencia Kundër Korrupsionit (tutje AKK) për të njëjtën situatë të cilën e ka vlerësuar dhe ka gjykuar me vendimin nr.274/20 duke cituar se të dy OE-të konkurrues sa i përket çështjes së konfliktit gjenden në të njëjtën situatë, ndërsa me vendimin e dytë nr. 594/20 interpreton opinionin juridik vetëm sa i përket OE të eliminuar pra tani paditës duke mos përdorur apo interpretuar opinionin nga AKK-ja edhe për Operatorin e rekomanduar për dhënie të kontratës .
6. Përfundimisht ka deklaruar se aktiviteti i prokurimit “Ndërtimi i parkut rekreativo-sportiv në Dardani dhe Renovimi i hapësirës”, është ndarë në dy faza. Faza e parë në të cilën fazë kanë marrë pjesë si projektues dy inxhinier S.L. dhe N.S., të dy të punësuar pran OE-ve konkurrues, S.L. inxhinier pran OE “BENI COM” tani paditës, ndërsa N.S. inxhinier pran OE “Rexha” i rekomanduar për dhënie të kontratës nga AK. E paditura opinionin juridik se në aktivitetin e prokurimit nr. 616-19-7632-5-1-1 me titull “Ndërtimi i parkut rekreativo-sportiv në Dardani dhe Renovimi i Hapësirës” gjatë fazës së implementimit të projektit nuk e ka të angazhuar fare si punonjës në këtë fazë të

implementimit të tenderit as si inxhinier dhe as si mbikëqyrës, duke e interpretuar këtë opinion juridik vetëm për OE “BENI COM”, tani paditës duke mos pasur parasysh faktin se e paditura në vendimin paraprak e ka cilësuar situatën njëjtë për të dy operatorët konkurrues. Ka shtuar e nga vendimet e OSHP-së të kundërta i kanë sjellur dëme të mëdha, andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovohet si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit, të detyrohet e paditura OSHP që të ndryshoj vendimin e kundërshtuar të datës PSH.nr. 594/20 të datës 30.09.2020, duke aprovuar në tërësi pretendimet në ankesë të paditësit OE “Beni Com” SH.P.K.

Kundërshtimet e të paditurës

7. Përfaqësuesi i të paditurës në përgjigje në padi ka deklaruar se, pretendimet e paraqitura në padi nga ana e paditësit nuk janë në pajtim me dispozitat ligjore për faktin se pretendimi i parë i paditësit se AK nuk e ka respektuar vendimin paraprak të OSHP-së Psh.nr. 274/20 të datës 15.06.2020 pasi që nuk ka kërkuar sqarime shtesë për natyrën e punëve të referencave dhe të kontratave, nuk është kontestuar nga Paneli shqyrtues pasi që me vendimin e atakuar me padi e ka konstatuar këtë pretendim si të bazuar, andaj kjo është arsyeja që ankesa ishte e aprovuar si pjesërisht e bazuar. Pretendimi tjetër i paditësit se vendimi i kontestuar është i nxjerr me shkelje të dispozitave të LPP-së sepse e paditura ka gjykuar përsëri të njëjtën çështje, të konfliktit të interesit, ku sipas paditësit edhe OE i rekomanduar për kontratë është gjendur në të njëjtën pozitë si paditësi, ndërsa sipas paditësit paneli shqyrtues nuk e ka interpretuar opinionin nga Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) për OE të rekomanduar për kontratë, ky pretendim është i pa bazuar pasi që vendimi i atakuar me padi e elaboron shumë qartë se opinionin e Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK) është nxjerr pas vendimit PSH.nr. 274/20 të datës 15.06.2020, ku aty flitet për dy punëtorët edhe S.L. punëtor i OE ankues edhe N.S. punëtor i OE të rekomanduar për kontratë. S.L. ishte në listën e muajit të dhjetë të vitit 2019 që i bie deri në momentin e nxjerrjes së listës së pagave nga ATK-ja, që do të thotë ishte punëtor kur është shpallur njoftimi për kontratë, kurse N.S. ishte në listën e pagave deri në muajin Maj të vitit 2018, pra kishte më shumë së një vitë e gjysmë që nuk ishte në listën e pagave nga koha kur janë dorëzuar ofertat. Aandaj nga ky konkludim konstatohet se është shpjeguar mjaftueshëm qartë se vetëm për njëri nga punëtorët, pra për S.L. punëtor në OE ankues tani paditës kishte pasur konflikt të interesit, ndërsa Paneli Shqyrtues ka nxjerr vendimin e kundërshtuar në përputhje me nenin 59 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që

të refuzohet si e pa bazuar padia e paditësit “BENI COM” SH.P.K., dhe të mbetet në fuqi vendimi i panelit shqyrtues i OSHP-së Psh.nr. 594/20 i datës 30.09.2020.

Provat e administruara

8. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Kërkesa për rishqyrtim e datës 21.04.2020, Ankesë e OE “Beni COM” SH.P.K. e datës 01.05.2020, Vendimi me nr. PSH.nr. 274/20 i datës 12.06.2020, ankesë e OE “BENI COM” SH.P.K., e datës 24.08.2020, Vendimi me nr. PSH .nr. 594/20 i datës 25.09.2020.
9. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenin 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, përgjigjen e të paditurës në padi, deklaratimet e tyre në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar.
10. Më datë 21.04.2020 OE “Beni Com” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ Ndërtimi i parkut rekreativo-sportiv në Dardani dhe renovimi i hapësirës”, nr. i prokurimit 616-19-7632-5-1-1.
11. Nërsa me datë 01.05.2020, Grupi i operatorëve Ekonomik “Beni COM” Linda SH.P.K., Euro Infrastruktura, ka parashtruar ankesë në OSHP kundër AK Kuvendi Komunal Prishtinë, sa i përket tenderit “Ndërtimi i parkut rekreativo-sportiv në Dardani dhe renovimi i hapësirës”, nr. i prokurimit 616-19-7632-5-1-1, me pretendimin se AK ka shkelur dispozitat ligjore të LPP-së përkatësisht nenet 1,7,52,59,60.
12. Nga Vendimi me nr. PSH.nr. 274/20 i datës 12.06.2020, Paneli Shqyrtues i OSHP-së në pikën I e ka a provuar si pjesërisht të bazuar ankesën e grupit të operatorëve ekonomik “Beni Com” SH.P.K., “Linda” SH.P.K., “Euro Infrastruktura” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i parkut rekreativo-sportiv në Dardani dhe renovimi i hapësirës”, nr. i prokurimit 616-19-7632-5-1-1, iniciuar nga AK Kuvendi Komunal Prishtinë, ndërsa në pikën II e ka anuluar njoftimin për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i parkut rekreativo-sportiv në Dardani dhe renovimi i hapësirës”, nr. i prokurimit 616-19-7632-5-1-1, me arsyetim se

AK fillimisht e kishte rekomanduar për dhënie të kontratës OE ankues duke publikuar njoftimin për dhënie të kontratës më datë 31.01.2020, mirëpo OE “Rexha”, si palë e pakënaqur me vendimin e AK-së ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimin pranë AK-së, kurse AK më datë 07.02.2020 e aprovon kërkesën e OE “Rexha”, si të bazuar duke e anuluar njoftimin për dhënie të kontratës, me arsyetim se OE ankues “BENI Com” ,“Linda” Com “Euro Infrastruktura”, nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, punë për ndërtim dhe rregullim të parqeve, shesheve dhe hapësirave tjera publike në tri (3) vitet e fundit në vlerë minimale prej 800,000.00 euro. Paneli Shqyrtues sa i përket këtij arsytimi të AK-së ka sqaruar se në ofertën e OE ankues “Beni Com”, gjenden kontrata me referenca me këtë kriter, mirëpo këto referenca janë kryesisht me shtrimin e asfaltit, kurse AK ka kërkuar në dosjen e tenderit më saktë në seksionin II “Fleta e të dhënave të tenderit” te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale”, pika 9.1&9.2 , është kërkuar që “ Operatori ekonomik duket të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, punë për ndërtim dhe rregullim të parqeve shesheve dhe hapësirave tjera publike në tri (3) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës), në vlerë minimale prej 800,000.00 euro, nëse tenderuesi është grup i OE-së lideri i grupit duhet të plotësoj 60%, të vlerës së referencave”, ndërsa grupi i OE ankues “Beni Com” SH.P.K.,“Linda” SH.P.K., “Euro Infrastruktura” SH.P.K., për këtë kërkesë së dosjes së tenderit ka bashkangjitur kontrata që kanë të bëjnë me “shtrimin e asfaltit”, dhe nuk kanë të bëjnë me rregullimin e parqeve apo të natyrës së ngjashme.

13. Paneli ka theksuar se sa i përket pretendimit të dytë të OE ankues se AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së duke mos i trajtuar në mënyrë të barabartë OE-të dhe duke vepruar në mënyrë jo të drejtë dhe diskriminuese duke anuluar vendimin e datës 31.01.2020 me të cilin AK e kishte shpallur fitues grupin e “Beni Com” SH.P.K., “Linda” SH.P.K., “Euro Infrastruktura” SH.P.K., me arsyetim se përveç që nuk plotëson 60% të vlerës së referencave për punimeve të ngjashme, ka të punësuar edhe një punonjës inxhinier S.L. që ka marr pjesë në një aktivitet të prokurimit me numër 616-118-094-221 dhe të njëjtin e ka quajtur konflikt interesi. OE ankues vazhdon të pretendoj se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës “Rexha” SH.P.K, i cili në tri (3) vitet e fundit 20169-2017-208 ka paraqitur punëtorin inxhinier N.S. arkitekt, i cili po ashtu ka punuar në të njëjtit aktivitet të prokurimit me punonjës in e OE “Beni Com”, pra në të njëjtin aktivitet të prokurimit kanë qenë të angazhuar inxhinier S.L. dhe Inxhinier N.S., ky i fundit ka qenë i punësuar

pran OE “Rexha” SH.P.K., në vitet 2016,2017, dhe 2018. OE ankues pretendon se lidhur me këta dy inxhinier, AK ka përdorur standarde të dyfishta duke mos i trajtuar në mënyrë të barabartë këta dy OE. Paneli Shqyrtues konform ekspertëve shqyrtues ka sqaruar se pretendimi i OE ankues lidhur me inxhinierët S.L. dhe N.S., ky pretendim është i bazuar sepse në vendimin e AK-së të datë 07.02.2020 ku janë bashkangjitur dokumentet e hartimit të projektit më saktë tek shtojca “ vendimi i projektuesit”, shihet që S.L. dhe N.S. kanë punuar në të njëjtin projekt, ku S.L. në cilësi të inxhinierit të ndërtimtarisë për fazën e strukturës kurse N.S. në cilësi të inxhinierit të arkitekturës. Të dy inxhinieret S.L. dhe N.S. kanë punuar në hartimin e projektit që ka të bëjë me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i parkut rekreativ-sportiv në Dardani dhe renovimi hapësirës” me numër 616-19-763-5-1-1. Sa i përket pretendimit të tretë të grupit të OE ankues “BENI Com” ,“Linda” Com “Euro Infrastruktura se AK ka shkelur nenin 52 të LPP-së duke e diskualifikuar grupin e OE ankues “BENI Com” ,“Linda” Com “Euro Infrastruktura se nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme se kanë përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, punë për ndërtim dhe rregullim të parqeve, shesheve dhe hapësira publike në 3 (tri), vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës në vlerë minimale prej 800,000.00 euro, duke qenë se tenderuesi është grup lideri i grupit duhet të plotësoj 60% të vlerës së referencave. Për këtë pretendim OE ankues se ka përfunduar si lider i punimeve kontrata si “ Rregullimi i qendrës së qytetit faza 2 segmenti 1.2.3 lokacioni i këtij projekti është sheshi para Komunës së Ferizajt në vlerë prej 243,607.53 euro, provë raporti për projektin Nr.05 i datës 07.08.2015 nga AK Komuna e Ferizajt si dhe fotot e vendit të ngjarjes së këtij projekti“Asfaltimi i rrugës të Xhamia në Podujevë”, me infrastrukturë përcjellëse ndriçim publik, kanalizim fekal, kanalizim atmosferik, rrjeti i ujësjellësit, sinjalizim horizontal dhe vertikal, urën mbi lumin Llap afër Kompleksit “Malësia”, lokacioni i këtij projekti është rreth lumit Llap në qendrën e Qytetit të Podujevës në vlerë prej 293,871,53 euro, provë raporti preliminar i pranimit teknik të punëve të kryera i datës 17.12.2019 nga AK Komuna e Podujevës dhe dhe fotot e vendit të ngjarjes së këtij projekti. Sipas këtyre llogaritjeve OE ankues ka pretenduar se ka të përfunduara si lider i grupit të OE-ve vlerën e punimeve 537,476,06 euro, e që sipas dosjes së tenderit duhet ti ketë 60 % të punimeve si lider i grupit te operatorëve Ekonomik që në vlerë i bie se duhet të ketë 480,000.00 euro punime me kontrata të ngjashme.

14. Paneli shqyrtues ka sqaruar se për këtë pretendim ankimor ka dhënë përgjigje tek pretendimi i parë që ka të bëjë me referencat dhe kontratat, ku edhe ky pretendim është

pjesërisht i bazuar sepse OE ankues në emalin e dërguar më datë 22.05.2020 ka bashkangjitur një dokument të skanuar ku në këtë dokument janë disa kontrata dhe referenca me të cilat dëshmohet se e plotëson kriterin e dosjes së tenderit që lideri i grupit duhet ti ketë 60% të punimeve me kontrata të ngjashme. Megjithatë, për panelin shqyrtues është e paqartë nëse këto kontrata janë të ngjashme sikurse ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit. Lidhur me pretendimin e grupit të operatorëve ekonomik ankues “Beni Com” SH.P.K., “Linda” SH.P.K., “Euro Infrastruktura” SH.P.K., se AK ka bërë shkelje të nenin 59 të LPP-së duke e shpallur fillimisht fitues grupin e OE ankues duke e konsideruar si grup të përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët në aktivitet të prokurimit, paneli shqyrtues ka sqaruar se ky pretendim është pjesërisht i bazuar për shkak se OE ankues ka dëshmuar që përmbush kriterin që ka të bëjë me referenca apo pranime teknike në shumën e caktuar, por që AK me qëllim të ekzaminimit dhe krahasimit sa më të drejtë të tenderëve do të duhej të sqaronte nëse këto kontrata, referenca janë të natyrës së ngjashme sikurse është kërkuar në dosjen e tenderit.

15. Sa i përket pretendimit të grupit të operatorëve ekonomik ankues se AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së duke mos e shpërblyer me kontratë grupin e OE ankues i cili ka ofertuar me vlerën më të ulët në këtë aktivitet të prokurimit, paneli shqyrtues ka sqaruar se ky pretendim është pjesërisht i bazuar për faktin se nëse OE ankues ka kontrata të ngjashme do të rezultonte me shkeljen e nenit 60 të LPP-së pasi që oferta e OE ankues është me çmim më të lirë në shumë prej 62,274.94 euro, se oferta e OE të rekomanduar për kontratë. Andaj Paneli Shqyrtues ka ardhur në përfundim se AK nuk e ka bërë ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve konform nenit 59 të LPP-së, andaj e ka obliguar AK-në që gjatë vlerësimit dhe krahasimet të tenderëve të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2, dhe 72 të LPP-së, nga OE ankues lidhur me natyrën e punëve të cilat i ka dëshmuar përmes referencave, duke pasur parasysh kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit.
16. Nga ankesa e OE “BENI COM” SH.P.K., e datës 24.08.2020, grupi i operatorëve ekonomik OE “Beni Com” SH.P.K., “Linda” SH.P.K., “Euro Infrastruktura” SH.P.K., më datë 24.08.2020 ka parashtruar ankesë në OSHP kundër AK Kuvendi Komunal Prishtinë, sa i përket tenderit “Ndërtimi i parkut rekreativo-sportiv në Dardani dhe renovimi i hapësirës”, nr. i prokurimit 616-19-7632-5-1-1, me pretendimin se AK ka shkelur dispozitat ligjore të LPP-së përkatësisht nenet 1,7,52,59,60, 72.

17. Nga Vendimi me nr. PSH .nr. 594/20 i datës 25.09.2020, paneli shqyrtues në pikën I e ka aprovuar si pjesërisht të bazuar ankesat e Operatorëve Ekonomik “Beni Com, SH.P.K., “Linda” SH.P.K., “Euro Infrastruktura, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i parkut rekreativo-sportiv në Dardani dhe renovimi i hapësirës”, nr. i prokurimit 616-19-7632-5-1-1, të iniciuar nga AK Kuvendi Komunal i Prishtinës dhe në pikën II të vendimit ka vërtetuar njoftimin për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i parkut rekreativ-sportiv në Dardani dhe renovimi i hapësirës”, nr. i prokurimit 616-19-7632-5-1-1, të iniciuar nga AK Kuvendi Komunal i Prishtinës, me arsyetim se lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues që ka të bëjë me kërkesën e dosjes së tenderit se OE ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, punë për ndërtim dhe rregullim të parqeve, shesheve dhe hapësirave tjera publike, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë), në vlerë minimale prej 800,000.00 euro, dhe nëse tenderuesi është grup i OE lideri i grupit duhet të plotësoj 60 % të lerës së referencave. Eksperti shqyrtues sqaron se për këtë pretendim ankimor është vendosur nga Paneli Shqyrtues në vendimin 274 /20 i datës 15.06.2020ku është konstatuar se “obligohet AK që gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së nga OE ankesë lidhur me natyrën e punëve të cilat i ka dëshmuar përmes referencave, duke pasur parasysh kërkesat e përcaktuara në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë. Duke e pasur parasysh pretendimin e OE ankues dhe vendimin paraprak të OSHP-së eksperti shqyrtues ka sqaruar se nuk ka hasur në ndonjë dëshmi të AK-së se ka kërkuar sqarime shtesë lidhur me këtë pretendim. Andaj, ky pretendim është i bazuar. Sa i përket pretendimit ankimor që ka të bëjë me konfliktin e interesit ku AK në letër standarde për tenderuesin e eliminuar, OE ankues e ka eliminuar me arsyetimin se në bazë të nenit 65 të LPP-së AK ka konstatuar se hartuesi i një pjesë të projektit-statistikës, Z. S.L. është punonjës i OE “Beni Com”, që dëshmohet në pasqyrat e trustit të dorëzuara nga vet OE. Paneli Shqyrtues ka sqaruar se në Letër standarde për tenderuesin e eliminuar dhe opinionit të Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK) me numër të referencës nr. AKK-DPKPP/03-03-845/20, AKK më datë 10.06.2020 ka nxjerr “Opinion”, ku ka konstatuar se ekziston konflikti i interesit në rastin e trajtuar me Nr. AKK-DPKPP/03-03-845/20 në aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i parkut rekreativ-sportiv në Dardani dhe renovimi i hapësirës”, nr. i prokurimit 616-19-7632-5-1-1, të iniciuar nga AK Kuvendi Komunal i Prishtinës. Paneli Shqyrtues ka sqaruar se AKK ka konstatuar se paraqitet konflikti i

interesit për faktin se S.L. punëtor i OE “Beni Com”, SH.P.K., ka marr pjesë në hartimin e specifikave teknike respektivisht në hartimin e dokumentacionit investivo-teknik për projektin “Renovimi i hapësirës tek posta Lagjja në Dardani”. Andaj Paneli shqyrtues duke e pasur parasysh opinionin e AKK-së ku ka konstatuar se OE ankues gjendet në konflikt interesi, pretendimin ankimor e ka vlerësuar si të bazuar. Lidhur me pretendimin e OE ankues se vendimi paraprak i OSHP-së qartë ka konstatuar se nuk ekziston konflikti i interesit dhe situata është e njëjtë me OE të rekomanduar për dhënie të kontratës prandaj vërehet diskriminimi ndaj OE ankues dhe favorizimi i OE “Rexha” SH.P.K., paneli shqyrtues ka sqaruar se pretendimi i OE ankues lidhur me konstatimin e ekspertit shqyrtues dhe panelit shqyrtues në vendimin paraprak të OSHP-së 274/20 se nuk ka konflikt interesi është i saktë, mirëpo duke e pasur parasysh se pas ekspertizës së ekspertit shqyrtues dhe vendimit të panelit shqyrtues PSH.nr. 274/20 është nxjerr Opinioni nga AKK, në të cilin opinion konstatohet se ka konflikt interesi, atëherë ka ndryshim të gjendjes pasi që AKK është kompetente për të konstatuar se kur ekziston konflikti i interesit në bazë të ligjit për konfliktin e interesit. Ndërsa sa i përket pretendimit se OE ankues është diskriminuar lidhur me punëtorin S.L., kurse OE i rekomanduar është favorizuar me punëtorin N.S. dhe se në se ka konflikt interesi për punëtorin S.L. (punëtor i OE ankues), ngjashëm është situata është me punëtorin N.S., sepse që të dy kanë qenë hartues të këtij projekti. Paneli Shqyrtues sqaron se në bazë të listës së pagave të OE ankues shihet që punëtori S.L. gjendet në listën e pagave deri në muajin Tetor të vitit 2019 (deri në momentin e nxjerrjes së listës së pagave nga ATK-ja), që do të thotë se ishte punëtor kur është shpallur njoftimi për kontratë. Kurse, sa i përket pretendimit që ka të bëjë me favorizimin e OE të rekomanduar për punëtorin N.S. Paneli Shqyrtues ka sqaruar se pas shqyrtimit të kontratave të punëtorëve dhe listës së pagave të nxjerr nga ATK-ja, rezulton se N.S. është në listën e pagave deri në muajin Maj të vitit 2018, konkretisht në bazë të listës së pagave i njëjti kishte më shumë se një vitë e gjysmë që nuk ishte në listën e pagave nga koha kur janë dorëzuar ofertat. Duke i pasur parasysh që N.S. nuk është në listën e pagave nga muaji Qershor 2018 dhe kishte një periudhë kohore më shumë se një vitë e gjysmë nga shpallja e njoftimit për dhënie të kontratës, respektivisht kishte më shumë se (6) muaj nga dorëzimi i planifikimit të prokurimit, atëherë rezulton se AK ka vepruar drejtë konform nenit 59 të LPP-së.

Baza Ligjore

18. Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (LPP), Neni 7 përcakton Barazinë në Trajtim/ Jo-Diskriminimi paragrafi 1 parasheh se “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”, paragrafi 2 parasheh se “Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik”.
19. Neni 52 përcakton njoftimin e kritereve për dhënien e kontratës paragrafi 1 parasheh se “*Autoriteti kontraktues në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit do të specifikoj kriteret që do të përdoren për dhënie të kontratës. Kriteret mund të jenë ose çmimi më i ulët ose tenderi ekonomikisht më i favorshëm*”, paragrafi 2 përcakton se “*Nëse autoriteti kontraktues ka specifikuar se kontrata publike do t’i shpërblehet operatorit ekonomik që ka paraqitur tenderin ekonomikisht më të favorshëm, autoriteti kontraktues në fjalë duhet të specifikojë në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit kriteret që do të merren parasysh gjatë vendosjes së fituesit dhe peshën që i është dhënë secilit kriter. Sa më shumë që është e mundshme, autoriteti kontraktues duhet të specifikojë çdo kriter në mënyrë objektive dhe kuantitative si dhe duhet të shprehë peshën që i është dhënë atyre*”,
20. Neni 59 përcakton Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve paragrafi 1 parasheh se *Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave*, paragrafi 2 parasheh se “Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve,, paragrafi 4 parasheh se “*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të*

kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”

21. Neni 60 përcakton Kriteret për Dhënien e Kontratës, paragrafi 1 përcakton se “Autoriteti kontraktues do t’ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar”, 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët; 1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kriterëve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52 të këtij ligji”.
22. Neni 72 përcakton se “Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji”.
23. **Neni 65** , përcakton **Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve paragrafi 1.** *Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose të marrë pjesë në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ndonjë punonjës, drejtues, menaxher ose drejtor i saj: 1.1. ka qenë pjesëmarrës në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit, ose në përgatitjen e ndonjë pjese të tyre, që shfrytëzohet nga autoriteti përkatës kontraktues; ose 1.2. ka pranuar ndihmë për përgatitjen e tenderit ose kërkesës për pjesëmarrje nga një person ose ndërmarrje që ka marrë pjesë në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit ose të ndonjë pjese të ndonjë pjese të këtyre të fundit. Paragrafi i 2. përcakton Pavarësisht nga dispozitat e më sipërme, autoriteti kontraktues duhet t’i japë operatorit ekonomik që s’kualifikohet sipas paragrafit 1 të këtij neni, një mundësi për t’i demonstruar autoritetit kontraktues se ai nuk ka arritur ndonjë përparësi në konkurrencë nga pjesëmarrja ose asistenca e tillë. Nëse operatorit ekonomik mund të ia demonstrojë këtë bindshëm autoritetit kontraktues, atëherë ai nuk shkualifikohet sipas paragrafit 1 të këtij neni. Të gjitha vendimet e autoritetit kontraktues për këtë çështje mund të apelojnë para OSHP-së nga operatori ekonomik ose ndonjë palë tjetër e interesuar.*

Vlerësimi i gjykatës

24. Pas vlerësimit të pretendimeve të përfaqësuesit të paditësit në seancë, deklarimeve në padi nga paditësi, kundërshtimeve sipas përgjigjes në padi nga e paditura, si dhe në bazë

të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 43 dhe 44 të LKA-së, dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

25. Nga provat e administruara Gjykata vlerësoj se projekti “Ndërtimi i parkut rekreativo-sportiv në Dardani dhe Renovimi i hapësirës”, e iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës ishte i ndarë në dy faza, në fazën e parë të aktivitetit të prokurimit “Ndërtimi i parkut rekreativo-sportiv në Dardani dhe Renovimi i hapësirës”, me nr. 616-18-094-2-2-1, kishin marrë pjesë të dy inxhinierët S.L. dhe N.S., të dy të punësuar pran OE-ve konkurrues, S.L. inxhinier pran OE “BENI COM” tani paditës, ndërsa N.S. inxhinier pran OE “Rexha” i rekomanduar për dhënie të kontratës nga AK.
26. Faza e dytë e projektit “Ndërtimi i parkut rekreativo-sportiv në Dardani dhe Renovimi i hapësirës”, me nr. 616-19-7632-5-1-1 ishte publikuar nga AK me datë 25.11.2019. Në atë kohë S.L. ishte në listën pagave deri në muajt e dhjetë të vitit 2019 (25 ditë para shpallës se tenderit) në momentin e nxjerrjes së listës së pagave nga ATK-ja, ndërsa N.S. ishte në listën e pagave deri në muajin Maj të vitit 2018. Duke u nisur nga fakti se Nases Surdulli nuk ishte i punësuar në kohën kur janë dorëzuar ofertat. Gjykata konstaton se nuk është vërtetuar se në çfarë periudhe kohore ishte punuar projekti ideor për fazën e dytë “Ndërtimi i parkut rekreativo-sportiv në Dardani dhe Renovimi i hapësirës”, me nr. 616-19-7632-5-1-1, për të vlerësuar nëse eksperti N.S. inxhinier pran OE “Rexha” i rekomanduar për dhënie të kontratës nga AK ishte i punësuar të OE “Rexha”, nga i cili do të mund të përfitonte ndihmë OE i rekomanduar për përgatitjen e tenderit ose kërkesës për pjesëmarrje, sipas nenit 65 të LPP-së.
27. Gjykata vlerëson se sipas vendimin të kundërshtuar eliminimi i paditësit ishte bërë sipas interpretimit të opinionit të Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK) me numër të referencës nr. AKK-DPKPP/03-03-845/20, AKK më datë 10.06.2020 ka nxjerr “Opinion”, ku ka konstatuar se ekziston konflikti i interesit në rastin e trajtuar me Nr. AKK-DPKPP/03-03-845/20 në aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i parkut rekreativo-sportiv në Dardani dhe renovimi i hapësirës”, nr. i prokurimit 616-19-7632-5-1-1, të iniciuar nga AK Kuvendi Komunal i Prishtinës, AKK kishte konstatuar se pjesëmarrje e inxhinierit S.L. punëtor i OE “Beni Com”, SH.P.K., në hartimin e specifikave teknike respektivisht në hartimin e dokumentacionit investivo-teknik për projektin “Renovimi i

hapësirës tek posta Lagjja në Dardani”, paraqet konflikt interesi. Ky interpretimi është në përputhje me Nenin 65, të LPP-së, paragrafi 1 ku përcaktohet se *Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose të marrë pjesë në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ndonjë punonjës, drejtues, menaxher ose drejtor i saj: 1.1. ka qenë pjesëmarrës në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit, ose në përgatitjen e ndonjë pjese të tyre, që shfrytëzohet nga autoriteti përkatës kontraktues; ose 1.2. ka pranuar ndihmë për përgatitjen e tenderit ose kërkesës për pjesëmarrje nga një person ose ndërmarrje që ka marrë pjesë në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit ose të ndonjë pjese të ndonjë pjese të këtyre të fundit.*

28. Mirëpo, gjykata vlerëson se sipas paragrafit të Nenit 65, të LPP-së, eliminimi i paditësit për këtë arsye, nuk do të duhet të ishte baza e vetme pa i dhënë një mundësi OE ankues te deklarohet, lidhur me faktin se a ka pranuar ndonjë përparësi në konkurrencë nga pjesëmarrja ose asistenca e tillë, kjo për faktin se inxhinieri S.L. ishte i punësuar tek OE paditës deri në muajin tetor 2019, ndërsa publikimi i njoftimit të këtij aktiviteti ishte bërë me datë 25.11.2020.
29. Duke marr për bazë, se pretendimet e paditësit janë vërtetuar si të bazuara edhe me vendimin e kundërshtuar se OE ankues ka dëshmuar që përmbush kriterin që ka të bëjë me referenca apo pranime teknike në shumën e caktuar, por që AK me qëllim të ekzaminimit dhe krahasimit nuk ka kërkuar sqarime nëse referencat janë të natyrës së ngjashme sikurse është kërkuar në dosjen e tenderit, siç parashihet në nenin 60 të LPP-së, sepse paditësi si lider i grupit të OE-ve ka dëshmuar vlerën e punimeve 537,476,06 euro, e që sipas dosjes së tenderit duhet ti ketë 60 % të punimeve si lider i grupit te operatorëve Ekonomik që në vlerë i bie se duhet të ketë 480,000.00 euro punime me kontrata të ngjashme, AK duke mos e shpërblyer me kontratë grupin e OE ankues i cili ka ofertuar me vlerën më të ulët në këtë aktivitet të prokurimit, AK ka shkelur nenin nenit 60 të LPP-së pasi që oferta e OE ankues është me çmim më të lirë në shumë prej 62,274.94 euro, se oferta e OE të rekomanduar për kontratë.
30. Prandaj gjykata vlerëson se në të dy rastet si më lart AK ka vepruar në shkelje të nenit Neni 7 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (LPP), me të cilin Autoriteti kontraktues obligohet ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të

barabartë dhe jo diskriminuese dhe të veprjës në mënyrë transparente”, sepse i njëjti ka vepruar në kundërshtim me nenin 59, 60, 65 dhe 72, duke shpallur fitues OE më të shtrenjtë për 62,274.94 euro.

31. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Lidhur shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 63 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.574/22, datë 21.05.2024.

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.